



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 651/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtar, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga Adnan Ademi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Shtime, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Shtime, paraqitur kundër vendimit të KQZ-së me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për shpalljen e rezultateve përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendet Komunale, të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e parashtruar nga Adnan Ademi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Shtime, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Shtime, paraqitur kundër vendimit të KQZ-së me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunale të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 09.11.2017, nga Adnan Ademi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Shtime, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Shtime, me të cilën pretendon se ka mospërputhje të rezultateve në mes FPR-së dhe rezultateve përfundimtare të KQZ-së, nga kjo mospërputhje e rezultateve është dëmtuar me humbjen e vendit në asamble për katër vitet e ardhshme.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të ankuesit gjeti se ankuesi me asnjë provë bindëse nuk ka dëshmuar dhe nuk ka specifikuar asnjë vendvotim me të cilën pretendon se janë shkaktuar parregullsi. Prandaj, Paneli ankesën e ankuesit e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tilla jo bindëse pasi që nuk i

plotësojnë kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar dhe e pa argumentuar dhe si të tillë ankesën e ankuesit e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.651/2017 më datën 10.11.2017.



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*